



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), në përputhje me autorizimet e tij, të cilat rrjedhin nga Protokolli Fakultativ i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Rregullorja e Punës së Avokatit të Popullit, më datë 31.08.2012 paraqiti **MENDIM** pranë Ministrisë për Punë të Brendshme të Republikës së Maqedonisë në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit të **Rregullores për mënyrën e kryerjes së punëve policore; Rregullores për veprimin e nëpunësve policorë me sendet përkohësisht të sekuestruara dhe të gjetura dhe Procedurat Standarde Operative për ndalim dhe veprim me personat e ndaluar.**

Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional, e përgatiti këtë Mendim në bazë të informatave për mangësitë e shfaqura në pjesën e veprimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, deri tek të cilat MPN-ja erdhi pas zbatimit të 24 vizitave parandaluese (të rregullta dhe të përsëritura kohë pas kohe) në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme.

Gjatë përgatitjes së këtij propozimi, MPN-ja u udhëheq nga të drejtat e garantuara të personave të privuar nga liria dhe obligimet e shtetit të cilat rezultojnë nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe dokumentet ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut, fillimisht duke u udhëhequr nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEMDNJ), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat e Qytetarëve dhe Politike (PNDQP) dhe Konventa e KB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, si dhe dokumente tjera ndërkombëtare me të cilat rregullohet në mënyrë më të detajuar trajtimi dhe realizimi i të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në lidhje me **Rregullore për mënyrën e kryerjes së punëve policore**, Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), dha mendim se, për personat të cilët privohen nga liria dhe të cilët ndalohen në stacion policor, kompetent duhet të jetë nëpunësi i posaçëm policor – personi për pranim, dhe jo këtë rol ta kryej përgjegjësi i turnit, i cili në përputhje me Ligjin për polici ka edhe detyra tjera të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e autorizimeve policore. Në bazë të 24 vizitave të realizuara të rregullta dhe të përsëritura kohë pas kohe nëpër stacionet policore, MPN-ja konsideron se zgjidhja ekzistuese, me të cilën përgjegjësi i turnit caktohet si nëpunës policor për pranim, nuk është adekuate dhe e arsyeshme. MPN-ja, në numër të madh të rasteve, sidomos në ato stacione policore të cilat mbulojnë territor më të madh dhe ku vëllimi i punëve policore është i konsiderueshëm, konstatoi se përgjegjësi i turnit nuk ka mundësi t'i zbatojë obligimet e nëpunësit për pranim, para së gjithash, duke e marr parasysh sigurinë e personit të privuar nga liria dhe realizimin e të drejtave të tij.

Më tej, MPN-ja propozoi masa të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e shtuar të integritetit personal dhe privatësisë së personave të cilët privohen nga liria, si dhe biseda me personat e arrestuar dhe të ndaluar të zhvillohet në ambient të caktuar për marrje në pyetje, e jo në

zyrat zyrtare të inspektorëve. Përveç të drejtave themelore të personave të privuar nga liria, Mekanizmi Parandalues Nacional, përmes mendimit të paraqitur sugjeroi se, gjatë periudhës së ndalimit në stacion policor, duhet të rregullohen edhe të drejtat e racioneve dhe ujit. Pastaj, MPN-ja kërkoi harmonizimin e kësaj Rregulloreje me Ligjin për kundërvajtje dhe Ligjin për të drejtat e të miturve, të cilët gjithashtu e rregullojnë materien e ndalimit të personave si dhe informimin e personit të ndaluar se brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e lëshimit në liri, të përcaktuar me Ligjin për procedurë penale, mund të kërkojë nga gjyqtari hetues i gjykatës kompetente ta shqyrtojë ligjshmërinë dhe këtë ta përcaktojë me aktvendim të veçantë.

Sa i përket **Rregullores për veprimin e nëpunësve policorë me sendet përkohësisht të sekuestruara dhe të gjetura**, MPN-ja, nga përvoja e deritanishme, konstatoi raste të ruajtjes në mënyrë jo të rregullt të sendeve të sekuestruara përkohësisht, përkatësisht nëpër zyrat e inspektorëve në disa stacione policore dhe mënyrën e këtyre të ruajtjes e konsideron si rrezik për sigurinë dhe shëndetin e personave të arrestuar dhe të ndaluar. Në këtë kontekst, MPN-ja propozoi që çdo send i sekuestruar përkohësisht të ruhet në lokal special të pajisur për këtë dedikim në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, dhe i njëjti të evidentohet dhe shënohet në mënyrë përkatëse. Vetëm nëpunësi policor kompetent për ruajtjen e tyre dhe përgjegjës për mbajtjen e evidencës së sendeve të sekuestruara përkohësisht të ketë qasje deri te lokali ku ruhen këto sende. Arma e sekuestruar përkohësisht duhet të ruhet në vend të mbyllur, në kasafortë të veçantë prej metali, në përbërje të lokalit për ruajtjen e këtyre sendeve.

MPN-ja dha mendimin e vet edhe për ndryshimin dhe plotësimin e **Procedurave Standarde Operative për ndalim dhe veprim me personat e ndaluar**. Mekanizmi Parandalues Nacional konsideron se në përputhje me parimet për veprim njerëzor me personat e privuar nga liria dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, personi i ndaluar ka të drejtë për ushqim dhe ujë. Personit të ndaluar duhet t'i sigurohet ushqimi, më saktësisht racioni në çdo 6 orë si dhe qasja deri te uji të freskët për pije. Njëkohësisht, ushqimi duhet të sigurohet nga buxheti i Ministrisë për Punë të Brendshme dhe për këtë qëllim Ministria për Punë të Brendshme duhet parashikojë pozicion të veçantë në Buxhet.

Krahas vërejtjes për rregullimin e çështjes së sigurimit të ujit dhe ushqimit për personat e ndaluar, MPN-ja dha mendim edhe për nevojën e thirrjes së mjekut, në rastet kur personi i ndaluar është nën ndikimin e alkoolit ose substancave tjera priskotrope, i cili duhet të konstatojë se personi mund të vendoset në ambientin për ndalim pa u rrezikuar shëndeti dhe jeta e vet personit.

MPN-ja dha mendimin e vet në lidhje me përdorimin e tualeteve, duke e pasur parasysh sigurinë dhe privatësinë e personave të cilët ndalohen në stacionet policore, mënyrën e zbatimit të kontrollit, si dhe ruajtjes së sendeve të sekuestruara të personave të ndaluar. Veçanërisht u potencua se në ambientet ku janë instaluar video monitorët dhe ku ndalohen personat, duhet të vendoset njoftim përkatës, ndërsa për video monitorimin të informohet personi i ndaluar, konform standardeve vendase dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.